



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 53, datë 21.05.2024

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VKB NR.123, DATË 13.07.2023 “PËR  
MIRATIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHËM TË KËSHILLIT BASHKIAK  
DHE PËRBËRJEN E TYRE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkoronja “b”, nenit 54, shkronja “a”, nenit 55 pika 3 dhe pika 6, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore” dhe sipas relacionit të përgatitur, me propozim të Kryetarit të Këshillit,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI :**



1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 123, datë 13.07.2023 “Për miratimin e komisioneve të përhershëm të Këshillit Bashkiak dhe përbërjen e tyre” si më poshtë vijon:
  - a. Lidhja nr.1, ndryshohet, shtohet dhe formulohet :
    - Pika 7 bëhet “ Komisioni i mardhënieve me jashtë *dhe integritit evropian*”.

b. Lidhja nr.2, shtohet dhe formulohet :

| 7. Komisioni i Mardhënieve me Jashtë dhe <b>Integritit Evropian</b> |            |                 |                  |
|---|------------|-----------------|------------------|
|   | Pozicioni  | Emër Mbiemër    | Subjekti politik |
| 1   | Kryetar    | Luan Nezha      | BF               |
| 2   | Zv/Kryetar | Ana Dharmo      | PS               |
| 3   | Sekretar   | Arlind Boshku   | BF               |
| 4   | Anëtar     | Dritan Rakipi   | PS               |
| 5   | Anëtar     | Llesh Çuni      | PS               |
| 6   | Anëtar     | Elisabeta Mataj | PS               |
| 7   | Anëtar     | Arjeta Keçi     | BF               |

2. Miratimin e kompetencave të këtij Komisioni, përveç kompetencave që ka si Komision i Mardhënieve me Jashtë, si më poshtë:
- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
  - Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
  - Merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
  - Janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë me mbështetjen e strukturës së Integritit Evropian organizojnë në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-së.
  - Njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-së, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura çdo herë në vit nga administrata e bashkisë.
  - Mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokal dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultatet mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku bashkia duhet të përformoj më mirë.



3. Ngarkohen Këshilltarët dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 22.05.2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 328/prot.  
18

Durrës, më 29.05.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**

28.05.24 5974/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.53 datë 21.05.2024 “Për miratimin e një ndryshimi në VKB nr.123, datë 13.07.2023 “Për miratimin e komisioneve të përhershëm të Këshillit Bashkiak dhe përbërjen e tyre”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

